

Durëzuar në Gjykatë
më 3 tetor 2019

[Signature]

GJYKATËS THEMELORE NË PRISHTINË
DEPARTAMENTI PËR ÇËSHTJE ADMINISTRATIVE

A Nr.1822/18

PADITËSI: Blerta Morina, me numër personal të identifikimit [redacted] me [redacted] Komuna e Gjakovës, e përfaqësuar nga Avokatja Rina Kika, me seli në Rr. Edith Durham B1 H.1 Nr.11, Prishtinë (sipas autorizimit në shkresat e lëndës)

E PADITURA: Agjencia për Regjistrimin Civil, Ministria e Punëve të Brendshme

DATA: 9 tetor 2019

LËNDA : Padë për konfliktin administrativ kundër Vendimit Nr.64-04 të nxjerrë nga Agjencioni për Regjistrimin Civil ("ARC") më datë 13 qershor 2018, të pranuar nga Paditësi më 26 qershor 2018

Parashtrim i argumenteve

të paraqitura gojarisht në seancën përgatitore

1. Mbetemi prapa argumenteve të paraqitura përmes padisë së parashtruar. Paditësi është transgjor dhe ka kërkuar që në Regjistrin e Gjendjes Civile t'i ndryshohet (1) emri nga "Blerta" në "Blert" dhe (2) shënuesi i gjinisë nga "F" në "M", në mënyrë që ato të reflektojnë identitetin e tij gjinor. Këto kërkesa janë refuzuar nga Zyra e Gjendjes Civile dhe ARC duke zbatuar gabimisht dispozitat ligjore dhe është konstatuar gabimisht gjendja faktike.
2. Gabimi në zbatimin e dispozitave ligjore gjatë nxjerrjes së vendimit në lidhje me kërkesën për ndërrim të emrit nga "Blerta" në "Blert" qëndron në faktin se nuk ekziston asnjë pengesë ligjore sipas nenit 18 të Ligjit për Emrin Personal që do ta lejonte ligjërisht refuzimin e kësaj kërkesë. Për më shumë, "mungesa e arsyeshmërisë" që është dhënë si arsye për refuzim nga ARC dhe ZGJC, nuk paraqet bazë ligjore për refuzim të kërkesës për ndërrim të emrit. Madje ky arsyetim në kontekstin e rastit të Paditësit është qartas diskriminues në bazë të identitetit gjinor pasi sipas ARC dhe ZGJC, të qenit transgjor nuk është arsye legjitime për të kërkuar ndërrimin e emrit. Prandaj kërkesa është refuzuar duke zbatuar gabimisht dispozitat ligjore.
3. Paditësi po ashtu kërkon nga gjykata që të konstatojë se ARC ka zbatuar gabimisht ë drejtën materiale dhe ka ardhur në përfundimet e gabuara në lidhje me rrethanat e rastit kur e ka refuzuar kërkesën e Paditësit për ndërrim të shënuesit të gjinisë, me arsyetimin se është

dashur të paraqitet raport mjekësor për “ndryshimet eventuale të përbërësve të gjendjes civile”.

4. GJEDNJ, në një rast të ngjashëm të vendosur në vitin 2017, AP, Garçon dhe Nicot kundër Francës, ka vendosur se refuzimi i kërkesave të parashtruesve transgjinorë për ndryshimin e gjendjes së tyre civile me arsyetimin se ata nuk kanë ofruar prova të pakthyeshme të ndryshimit të dukjes së tyre – pra që iu kanë nënshtruar ndërhyrjeve kirurgjike apo trajtimit mjekësor i cili përmban një mundësi të madhe të sterilizimit – ka për pasojë dështimin e shtetit në përmbushjen e obligimeve pozitive për të siguruar të drejtën në jetë private. Andaj, në lidhje me këtë kushtëzim GJEDNJ ka vendosur se është shkelur e drejta në privatësi e parashtruesve.

5. Baza kryesore mbi të cilën është mbështetur Vendimi i ARC në rastin e Paditësit është se Paditësi nuk ka ofruar raportin mjekësor i cili i evidenton ndryshimet në gjininë e Paditësit. Si i tillë, ky kushtëzim njohjes ligjore të identitetit gjinor të Paditësit është në kundërshtim me praktikën gjyqësore të GJEDNJ e cila është autoriteti kryesor për interpretimin e lirive dhe të drejtave të njeriut në Kosovë sipas nenit 53 të Kushtetutës, dhe e shkelë të drejtën e Paditësit në jetë private që garantohet me Kushtetutë.

6. Paditësi kërkon kompensimin e dëmit jo-material për shkak të shkeljes së lirive dhe të drejtave të tij dhe për shkak të shkakimit të shqetësimit dhe vuajtjes psikike si rrjedhojë e mos-njohjes së identitetit të tij gjinor.

7. Konsiderojmë se është me rëndësi që kjo Gjykatë, gjatë shqyrtimit të kësaj çështjeje të marrë parasysh Aktgjykimin **AA.nr.244/2019** të Gjykatës së Apelit, Departamenti për Çështje Administrative në rastin *M.P. kundër Ministrisë së Punëve të Brendshme, Departamenti i Regjistrimit dhe Gjendjes Civile në Prishtinë* të datës 02 gusht 2019. Ky vendim paraqet një vendim meritator të nxjerrë nga Gjykata e Apelit që ka rrethanat e ngjashme faktike me këtë çështje administrative, prandaj po ia paraqesim kësaj Gjykate në kopje të mjaftueshme.

8. Rrjedhimisht kërkojmë që kjo Gjykatë që pas shqyrtimit të të thënave të padisë dhe provave të bashkëngjitura ta aprovojë padinë si plotësisht të bazuar, të konstatojë se vendimi i ARC-së është diskriminues në bazë të identitetit gjinor, ta urdhërojë Agjencinë e Regjistrimit Civil t’ia ndërrojë Paditësit emrin dhe shënuesin e gjinisë në përputhje me identitetin e tij gjinor, si dhe ta aprovojë kërkesën e Paditësit për kompensim të dëmit jo-material për shkak të shkeljes së të drejtave të tij.


Rina Kika

Avokate

rina@kika-associates.com

Rr. Edith Durham B 1 H.1 Nr.11

10000 Prishtinë - Kosovë

Avokate - Attorney at law

RINA KIKA

1655/17

Rr. Edith Durham B1 H1 Nr.11

Prishtinë, Kosovë

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Çështje Administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Ramiz Kuqi kryetar, Delushe Halimi dhe Gani Avdiu, anëtarë, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditëses M.P., nga fshati ..., Komuna ..., kundër të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme – Departamenti i Regjistrimit dhe Gjendjes Civile në Prishtinë, me bazë juridike anulim i vendimit, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.2196/2017, të datës 27.12.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 02.08.2019, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme – Departamenti i Regjistrimit dhe Gjendjes Civile në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.2196/2017, i datës 27.12.2018, vërtetohet.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, me aktgjykimin, A.nr.2196/2017, të datës 27.12.2018, e ka aprovuar si të bazuar kërkesën e paditëses M.P., nga fshati ..., Komuna ..., ndërsa ka anuluar vendimin e të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme – Departamenti i Regjistrimit dhe Gjendjes Civile në Prishtinë, me nr.113/2017, të datës 27.10.2017, dhe vendimin e Komunës së Prizrenit, Drejtoria e Administratës – Zyra e Gjendjes Civile, me numër Nr.02-201/01-112711, të datës 11.09.2017, dhe detyrohet Drejtoria e Administratës së Përgjithshme e Komunës së Prizrenit, që të bëjë korrigjimin e emrit personal nga M(femrore, shënim i zyrtarit për anonimizim) në M.(mashkull, shënim i zyrtarit për anonimizim) dhe ndërrimin e gjinisë nga femër në mashkull, dhe këto korrigjime të evidentohen në regjistrin themeltar dhe regjistrin qendror të gjendjes civile, dhe në tërë përbërësit tjerë të gjendjes civile, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ka ushtruar ankesë përfaqësuesja e autorizuar e të paditurës, Ministria e Drejtësisë – Avokatura Shtetërore, për shkak të: shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Me propozim që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet, dhe lënda të kthehet në rigjykim.

Gjykata e Apelit shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 194 të

Ligjit mbi Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit mbi Konfliktet Administrative (LKA), gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me vendimin e organit të paditur Ministria e Punëve të Brendshme – Departamenti i Regjistrimit dhe Gjendjes Civile në Prishtinë, me nr.113/2017, të datës 27.10.2017, nën pikën I të dispozitivit të vendimit, mbetet në fuqi vendimi Nr.02-201/01-112711, i datës 11.09.2017, i Drejtorisë për Administratë – Komisioni i Zyrës së Gjendjes Civile për Ndërrim dhe Korrigjim të Emrit Personal në Drejtorinë e Administratës në Prizren. Nën pikën II të dispozitivit të vendimit, është refuzuar ankesa e znj. M.P., nga fshati ..., Komuna ..., e lindur me datë 28.09.1981, në ...ë, nga prindërit, babai ..., dhe nëna ..., e cila kërkon që ti mundësohet ndërrimi i gjinisë nga femër në mashkull në Regjistrat e Gjendjes Civile.

Paditësja e pakënaqur me vendimin e Ministrisë së Punëve të Brendshme – Departamenti i Regjistrimit dhe Gjendjes Civile në Prishtinë, me nr.113/2017, të datës 27.10.2017, ka ushtruar padi për konflikt administrativ me datën 26.12.2017, me propozim që i njëjti të anulohet si i kundërligjshëm.

Gjykata e shkallës së parë pasi vlerësoi vendimin e kundërshtuar dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të shqyrtimit gjyqësor, e duke u bazuar në provat dhe dokumentacionin që gjendet në shkresat e lëndës, bie aktgjykimin e ankimuar, me të cilin e aprovon kërkesëpadinë e paditëses si të bazuar, duke anuluar vendimin e të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme – Departamenti i Regjistrimit dhe Gjendjes Civile në Prishtinë, me nr.113/2017, të datës 27.10.2017, dhe vendimin e Komunës së Prizrenit, Drejtoria e Administratës – Zyra e Gjendjes Civile, me numër Nr.02-201/01-112711, të datës 11.09.2017, si dhe duke detyruar Drejtorinë e Administratës së Përgjithshme të Komunës së Prizrenit, që të bëjë korrigjimin e emrit personal nga M. në M. dhe ndërrimin e gjinisë nga femër në mashkull. Me arsyetim se vendimet e lartcekura përmbajnë të meta të tilla për shkak të të cilave nuk mund të shqyrtohet ligjshmëria e tyre, ngase të njëjtit janë juridikisht të pa qartë dhe kundërtënës me vetveten dhe me arsyetimin e tyre, sepse në arsyetimin e tyre nuk janë dhënë arsye për faktet vendimtare që kanë kushtëzuar marrjen e vendimeve të kundërshtuara.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje të dispozitave procedurale të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të kontestuar në kuptim të nenit 44 të Ligjit për Konfliktet Administrative, në drejtim të pretendimeve në padi, në përgjigje në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës, me të drejtë iu ka referuar Kushtetutës së Republikës së Kosovës, përkatësisht neneve 23, 24 dhe 53. Sepse me nenin 23 përcaktohet se “Dinjiteti i njeriut është i pacenueshëm dhe është bazë e të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut”. Me nenin 24 përcaktohet se “1. Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim. 2. Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve

politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal. 3. Parimet e mbrojtjes së barabartë ligjore nuk parandalojnë vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë. Masat e tilla do të zbatohen vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin janë vënë ato”. Ndërsa me nenin 53 përcaktohet se “Të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”. Po ashtu, gjykata e shkallës së parë me të drejtë iu ka referuar edhe Ligjit Nr.02/L-118 për Emrin Personal, përkatësisht neneve 12 dhe 18. Sepse me nenin 12 përcaktohet se “Qytetari i moshës madhore mund ta ndërrojë emrin personal në bazë të kërkesës së tij”. Ndërsa me nenin 18 përcaktohet se “18.1. Qytetari kundër të cilit zhvillohet procedura për veprë penale për të cilën ndiqet sipas detyrës zyrtare i cili është dënuar për veprë të këtillë penale, derisa nuk i është ekzekutuar dënimi ose gjithnjë derisa të vazhdojnë pasojat juridike të dënimit, si dhe as personit për të cilin konstatohet se kërkesën e ka paraqitur për t’iu shmangur detyrimeve të përcaktuara me ligj, nuk do t’i lejohet ndërrimi i emrit personal. 18.2. Nëse emri personal i është ndërruar qytetarit, kundër të cilit zhvillohet procedura penale për veprë penale, zyra e gjendjes civile që në afatin prej tre ditësh pas aprovimit të ndërrimit duhet ta njoftojë gjykatën në të cilën zhvillohet procedura penale. 18.3. Zyra e regjistrimit civil mund të kërkoj nga Gjykata dhe Prokuroria verifikimin e vërtetësisë të të dhënave të parashtruara nga aplikuesi lidhur me dokumentet nga neni 17 i këtij ligji. 18.4. Nëse emri personal është ndërruar me kërkesë të palës në procedurë administrative të organit të gjendjes civile, për pesë vitet e ardhshme, palës nuk do t’i lejohet sipas së njëjtës procedurë ndërrimi i serishëm i emrit personal nga organi i gjendjes civile. Gjithashtu, gjykata e shkallës së parë me të drejtë iu ka referuar edhe Ligjit Nr.05/L-020 për Barazi Gjinore, përkatësisht nenit 3 par.1 pika 1.9, me të cilin përcaktohet se “1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim: 1.9. Identiteti gjinor - kjo karakteristikë e mbrojtur mbulon identitetin që ka të bëjë me gjininë e një personi dukjen apo karakteristikat tjera që lidhen me gjininë e një personi (qoftë përmes ndërhyrjes kirurgjike apo jo) duke mos marrë parasysh seksin që personi e ka pasur në lindje”. Gjykata e shkallës së parë me të drejtë iu ka referuar edhe Udhëzimit Administrativ Nr.19/2015 për Kushtet dhe Procedurat e Ndërrimit dhe Korrigjimit të Emrit Personal, përkatësisht nenit 5 dhe 6 par.1 pika 1.8. Sepse me nenin 5 përcaktohet se “1. Shtetasi i Republikës së Kosovës i moshës madhore mund ta ndërrojë emrin personal në bazë të kërkesës së tij, nëse i plotëson kriteret si në vijim: 1.1. Nëse kërkesa për ndërrimin e emrit personal bëhet vetëm nga pala personalisht, ndërsa për fëmijën prindi ose kujdestari; 1.2. Nëse kërkesa për ndërrimin e emrit personal nuk ka karakter fyes, imoral, racist, ose nëse nuk është në kundërshtim me të drejtat dhe liritë e njerëzve të tjerë, apo të vet personit; 1.3. Nëse kanë kaluar pesë (5) vite nga ndërrimi i fundit i emrit personal sipas nenit 18, paragrafit 4 të Ligjit nr. 02/L-118 për Emrin Personal; 1.4. Nëse qytetari kundër të cilit zhvillohet procedurë për veprë penale për të cilën ndiqet sipas detyrës zyrtare i cili është dënuar për veprë të këtillë penale, ndërsa nuk i është ekzekutuar dënimi ose gjithnjë derisa të vazhdojnë pasojat juridike të dënimit, si dhe as personit për të cilin konstatohet se kërkesën e ka paraqitur për t’u shmangur detyrimeve të përcaktuara me ligj, nuk do t’i lejohen ndërrimi i emrit personal”. Ndërsa me nenin 6 par.1 pika 1.8 përcaktohet se “1. Shtetasi mund ta bëjë ndërrimin e emrit personal për arsytet si në vijim: 1.8. Emri personal e pengon integritetin e personit në shoqëri”.

Nga provat e administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, gjykata me të drejtë ka vërtetuar se paditësja i ka përmbushur kriteret nga neni 5 i Udhëzimit Administrativ Nr.19/2015 për Kushtet dhe Procedurat e Ndërrimit dhe Korrigjimit të Emrit Personal, dhe se nuk ekzistojnë pengesa për ndërrimin e emrit personal nga neni 18 i Ligjit Nr.02/L-118 për Emrin Personal. Po ashtu, në mënyrë të drejtë është vërtetuar se paditësja i ka përmbushur kërkesat nga neni 1, 1.3, 1.8 dhe 1.9 të Ligjit Nr.05/L-020 për Barazi Gjinore, si dhe neneve 23, 24 dhe 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, për ndërrimin e gjinisë. Gjykata e shkallës së parë drejtë ka vlerësuar se e paditura me rastin e refuzimit të kërkesës së paditëses për ndërrimin e emrit të saj, nga M. në M., dhe gjinisë nga femër në mashkull, ka bërë cenimin e të drejtës së saj për privatësi nga neni 8 i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, dhe nenit 36 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, pasi që e paditura ia ka mohuar të drejtën që ti njihet emri dhe identiteti i saj gjinor. Sepse e drejta në mbrojtjen e identitetit gjinor mbrohet brenda të drejtës së privatësisë sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ. Sipas GJEDNJ, koncepti i të drejtës në jetë private është term i gjerë, dhe nuk mund të kapet në një përkufizim të ngushtë, sepse ai përfshinë integritetin fizik dhe psikik të një personi, dhe ndonjëherë mund të përfshijë edhe aspekte të identitetit fizik dhe social, elementet të tilla si p.sh identifikimi gjinor, emri, orientimi seksual dhe jeta seksuale hynë brenda sferës personale të mbrojtura me nenin 8 të Konventës. Prandaj, duke qenë se në vetë esencën e KEDNJ qëndron respekti për dinjitetin, e edhe liritë njerëzore, e drejta e personave transgjinor në zhvillim personal, siguri fizike dhe morale, është e mbrojtur nga konventa. Andaj, aktgjykimi i ankimuar si i tillë është i pranueshëm edhe për kolegjin e kësaj gjykate.

Sa i përket pretendimeve ankimore për shkelje të dispozitave procedurale, këto pretendime nuk qëndrojnë, meqë gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht e ka dërguar padinë përfaqësuesit të së paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerr prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë, nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LPA-së, LKA-së dhe LPK-së.

Ndërsa, sa i përket pretendimeve ankimore për vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, se gjykata e shkallës së parë nuk është bazuar në faktet e dhëna nga e paditura, mirëpo gjendjen faktike e ka nxjerrë komplet nga provat e paditëses, që janë jo të plota dhe të gabuara. Kolegji i kësaj gjykate këto pretendime ankimore nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se të njëjtat janë të pa bazuara dhe të paqëndrueshme për tu aprovuar ankesa, dhe si të tilla janë pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë.

Nga tërë kjo që u cek më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditurës. Prandaj pretendimet ankimore se aktgjykimi i ankimuar përmban shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga nenin 182 të LPK-së, ngase gjykata e shkallës së parë me rastin e marrjes së aktgjykimit të ankimuar nuk i ka vlerësuar drejtë provat e paraqitura nga ana e të paditurës, por arsyetimin e aktgjykimit e bazon thjeshtë në provat dhe të dhënat të cilat i arsyeton përfaqësuesja e paditëses. Këto pretendime ankimore ky kolegji nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se të njëjtat janë të pa bazuara dhe pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike, për faktin se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të pa kontestuar ka vërtetuar gjendjen

faktike, se paditësja i ka përmbushur kriteret nga neni 5 i Udhëzimit Administrativ Nr.19/2015 për Kushtet dhe Procedurat e Ndërrimit dhe Korrigjimit të Emrit Personal, dhe se nuk ekzistojnë pengesa për ndërrimin e emrit personal nga neni 18 i Ligjit Nr.02/L-118 për Emrin Personal, si dhe i ka përmbushur kërkesat nga neni 1, 1.3, 1.8 dhe 1.9 të Ligjit Nr.05/L-020 për Barazi Gjinore, si dhe neneve 23, 24 dhe 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, për ndërrimin e gjinisë. Prandaj, aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm, si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, andaj, ankesa e të paditurës si e tillë u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - PRISHTINË
AA.nr.244/2019 më datë 02.08.2019

Kryetari i kolegjit,
Ramiz Kuqi